

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË  
STUDIMET PASUNIVERSITARE – MASTER  
DREJTIMI – KOHA E RE



REZYME E TEMËS SË MASTERIT

me titull:

ZHVILLIMI I ARSIMIT DHE KULTURËS NË SKENDERAJ 1945 – 1974

Kandidatja:

Hafize Veliqi – Gecaj

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Qershor, 2024

Punimi Zhvillimi i arsimit dhe kulturës në Skenderaj 1945 – 1974 është strukturuar krahas zhvillimit të arsimit dhe kulturës në të gjitha vendet botërore, padyshim se një rëndësi të madhe për ne ka edhe se si është zhvilluar arsimi tek ne, në Kosovë në përgjithësi. Mirëpo unë do të ndalem vetëm tek zhvillimi i arsimit në rajonin e Drenicës. Dhe pse e dimë se është e pamundur që të shkëputët vetëm ky rajon, nga pjesa tjetër e Kosovës, në mënyrën se si është zhvilluar arsimi, ku ka ngjashmëri, por edhe të veçantat e saja. Punimi përbëhet nga tre kapituj dhe disa nëntituj si në vijim:

Kapitulli i parë trajton fillimin e Luftës së Dytë Botërore, saktësisht ngjarjet që kanë ndodhë në këto treva gjatë kësaj kohe dhe se si ka qenë, gjendja e popullsisë shqiptare në zonën e Drenicës më fillimin e kësaj lufte. Se si është ardh mundësia deri të hapja e shkollave të para shqipe gjatë viteve 1941 – 1943 dhe se ka vazhduar mësimi në gjuhën shqipe pas kapitullimit të Italisë në shtator të vitit 1943.

Në kapitullin e dytë parqet zhvillimin e arsimit në Skenderaj gjatë viteve 1945 – 1968, se cilat qenë pasojat për shkollat në gjuhën shqipe, në Kosovë pas ardhjes së pushtetit komunist në Jugosllavi. Fillimi i rihapjes së shkollave pas përfundimit të luftës dhe pengesat që ishin në këtë periudhë si dhe për arsimin në gjuhën shqipe në zonën e Drenicës pas prishjes së marrëdhënieve Shqipëri – Jugosllavi e deri në ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1974.

Kapitulli i tretë elaburon zhvillimi i kulturës në Drenicë, aspekte kulturore në Skenderaj pas Luftës së Dytë Botërore, themelimin e bibliotekave shkollore, themelimin e Ansambllit “Drenica” në Skenderaj, kontributin e këtij ansambli në ngritje të vetëdijes kulturore.

Arsimi është shumë i lashtë, por sistemet arsimore kombëtare sendërtohen në shtete kombëtare të pavarura. Sistemet kombëtare të arsimit u sendërtuan pas Revolucionit të Madh Francez, gjegjësisht gjatë shekullit XIX. Arsimi dhe edukata janë faktorë përcaktues të komponentësh së zhvillimit kulturor e shpirtëror të një populli. Si i tillë, faktori kulturor-arsimor luan rol shumë të srëndësishëm në formimin e karakteristikave themelore të vetëdijes kombëtare dhe të superstrukturës shoqërore. Në hapësirën tonë shqiptare gjatë historisë arsimit ka kaluar në etapa të ndryshme. E lashtë është edhe historia e arsimit shqiptar, e cila është e ndërlidhur më historinë e këtij populli, ngase pushtuesit imponuan edhe arsimin e tyre. Edhe në këto kushte, shqiptarët bënë përpjeke për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe për ruajtjen e identitetit etnik të tyre.

Situata e krijuar në shkollimin e fëmijëve shqiptarë gjatë shekullit XX, përkatësisht në vitet 1945 – 1974, serbët kishin dy qëllime njëri që sa më shumë shqiptarë të largoheshin nga Kosova, fat të cilin pa dyshim e kishte edhe Skenderaj, kurse tjetri nëse nuk kishte mundësi që të i largonin t'i asimilonin. Rruga më e mirë për t'i arritur këto qëllime ishte mos shkollimi i shqiptarëve, që të mbetnin analfabet dhe të manipuloheshin sa më lehtë. Andaj dhe përqindja e analfabetizimit ishte shumë e lartë madje shkonte edhe mbi 90% analfabet shqiptarë nën Mbretërinë jugosllave.

Lufta e Dytë Botërore ishte një fatkeqësi për njerëzimin, por sa u përket shqiptarëve situata e tyre ndryshoi dukshëm madje edhe u përmirësua. Edhe pse duket paradoksale, por është e vërtete se situata për shqiptarët në Kosovë ishte më e mirë gjatë sundimit italian dhe gjerman, se sa nën atë serb. Kjo ishte periudhë kur filluan që të hapeshin shkollat shqipe dhe të zvogëlohej sa do pak analfabetizimi.

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, ishte një rikthim për Kosovën nën pushtimin jugosllav, vetëm se tani forma e pushtimit ishte ndryshuar në krahasim me atë të para luftës. Forcat komuniste të Jugosllavisë të udhëhequra nga Tito, në propagandën e tyre e kishin që duhej të zhdukej analfabetizimi dhe duhej tu jepeshin të drejta pakicave kombëtare. (Edhe pse populli shqiptarë në Jugosllavi nuk ishte pakicë, por ishin rreth dy milion shqiptarë që banonin në këtë shtet). Kështu në bazë të kësaj propaganda u hapën shkollat edhe në gjuhën shqipe në vendet ku jetonin shumica shqiptare. Ndarja është bërë në tri periudha apo etapa të ndryshme si në vijim: Periudha e parë në kohën e komunizmit ishte ajo në mes viteve 1945 – 1948. Në këtë periudhë ishte bashkëpunimi në mes komunistëve të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, ku ende lejoheshin mësuesit nga Shqipëria që të jepnin mësim në Kosovë, e kjo kuptohet edhe në Skenderaj. Pas prishjes së marrëdhënieve në mes të dy shteteve në fjalë situata për arsim u përkeqësua, edhe pse fatbardhësisht nuk u mbyllën shkollat në gjuhën shqipe, mirëpo mungonte kuadri arsimor. Andaj filluan që të merreshin si mësimdhënës të pakualifikuar që ndikoi edhe në rënien e cilësisë së mësimin. Por pas hapjes së normaleve filloi që të ngritej prapë cilësia deri diku.

Në vitin 1970 u hap Universiteti i Prishtinës që ishte një arritje e madhe për popullin shqiptar nën Jugosllavi.

Në kudër të gjitha këtyre pa dyshim së përfshihet edhe Skenderaj, vetëm se për dallim nga rajonet tjera të Kosovës, sa i parkete arsimin ishte pak më e prapambetur për shkak të trysnisë së madh që i shkaktonte pushteti i atëhershëm.

Megjithatë, në fund të viteve të 70-ta edhe këtu u përmirësua dukshëm situata në arsim dhe në kulturë tani më i gjejmë edhe fillesat e shoqërive kulturore – artistike në Skenderaj të përfshira në disa aktivitete në prezantimin dhe ngritjen kulturore dhe kombëtare.

Prandaj, qëllimi i këtij punimi do të mbetet përgjithmonë, në dhënien e kontributit tim modest, për të trajtuar zhvillimin e arsimit dhe të kulturës në Skenderaj.